

## RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

**“Mbi kryerjen e auditimit ligjor te detyrueshem te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate vitit kalendarik 2011” nga “PARTIA TOLERANCE E RE E SHQIPERISE”.**

**Drejtuar : - KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**TIRANË**

**PARTISE TOLERANCA E RE E SHQIPERISE**

**FUSHE - KRUIJE**

Të nderuar zotërinj,

Unë, **Naim MALO**, në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin Nr.06 datë 04.04.2012 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve kontabel te licensuar, te cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga Partite Politike per vitin kalendarik 2011”, si dhe në Kontratën e Shërbimit datë 24.05.2012 të lidhur me KQZ, kam kryer auditimin e pasqyrave financiare per fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga **“Partia Toleranca e Re e Shqiperise”** për vitin kalendarik 2011. Kjo pasqyre eshte pergjegjesi e drejtimit te **“Partia Toleranca e Re e Shqiperise”**. Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi kete pasqyre bazuar ne auditimin tone.

Ne e kryem auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit (SNA). Keto standarte kerkojne, qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditim per te zoteruar siguri te arsyeshme, se kjo pasqyre nuk permban anomali materiale. Auditimi perfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyren financiare. Auditimi perfshin gjithashtu , vleresimin e parimeve te kontabilitetit te ndjekura dhe vleresimet e rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjishme te pasqyres. Ne cmojme se auditimi yne perben nje baze te arsyeshme per te shprehur nje opinionin tone.

Politika kontabile e ndjekur nga ana e kesaj organizate eshte te pergatise pasqyren bashkelidhur mbi bazen e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te realizuara gjate periudhes se vitit kalendarik 2011. Mbi kete baze, fondet e perfituara njihen kur fitohen ne lek ose ne materiale dhe sherbime te konvertuara dhe shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.